



Breaking News:

Tiranë – Transportoi lëndë piroteknike (kapsolla plasëse), me furgonin e tifozëve, me qëllim për ti futur në stadium, gjatë ndeshjes Partizani-Kukësi, procedohet penalisht drejtuesi i automjetit

⏏ ⏪ ⏩



05/05/2023

Dibër – Goditet Një Rast I Mbajtjes Pa Leje Të Armës Së Zjarrit, Në Banesë

Dibër

Goditet një rast i mbajtjes pa leje të armës së zjarrit, në banesë.

Falë inteligjencës informative, Policia sekuestron një armë zjarri kallashnikov që e posedonte një 15-vjeçar.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Dibër, si rezultat i administrimit të menjëhershëm të informacioneve të siguruara nga intelijenca informative, për një rast armëmbajtjeje pa leje, kanë ushtruar kontroll në banesën e shtetasit F. K., në Maqellarë.

Nga kontrolli në këtë banesë, shërbimet e Policisë gjetën një armë zjarri kallashnikov që posedohej pa leje nga ky shtetas.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, u sekuestrua arma e zjarrit kallashnikov, si dhe u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin F. K., 15 vjeç.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”.

